

Nr: 1076 Prot

dt: 23.03.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Shekulli ED,
[Signature]

Nr. 1077/ prot.

Tiranë, më 18.05.2022

Lënda : Mbi shpalljen e vendit vakant për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
UNIVERSITETIT TË TIRANËS
UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS
UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT, TIRANË
UNIVERSITETIT "LUARASI"
UNIVERSITETIT "BARLETI"
KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"
UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS
KOLEGJIT UNIVERSITAR "WISDOM"
UNIVERSITETIT "EPOKA"
UNIVERSITETIT MESHETAR TË SHQIPËRISË
KOLEGJIT UNIVERSITAR "TIRANA BUSINESS UNIVERSITY"
KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR"
KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BISNESIT

Të nderuar,

Sipas përcaktimeve të nenit 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 134, 135 dhe 137 të ligjit nr. 115/2016, "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 3, datë 11.03.2022, vendosi "***Shpalljen e një vendi vakant për anëtar të Këshillit të Lartë të***

Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës”.

Sa më sipër, kërkohet nga ana juaj marrja e masave për shpalljen e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik dhe nga pedagogët e Shkollës së Magjistraturës sipas përcaktimeve të nenit 135, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni:

- vendimin nr. 3, datë 11.03.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit;
- njoftimin për shpalljen e vendit vakant;
- formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- formular aplikimi për informim për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta (AIDSSH);
- formular deklarimi për konfliktin e interesit.

Falënderime për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1077 Prot.

Tiranë, më 11.03.2022

V E N D I M

Nr. 3, Datë 11.03.2022

**“PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË, PËR KANDIDATËT NGA TRUPA E
PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE SHKOLLA E
MAGJISTRATURËS”**

Në mbështetje të nenit 135, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 dhe 16, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S A:

1. Të shpall një vend vakant për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.
2. Shpallja e vendit vakant dhe kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët, sipas nenit 134 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

GENCI GJONCAJ

NJOFTIM PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Sipas përcaktimeve të nenit 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 134, 135 dhe 137 të ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 3, datë 11.03.2022, vendosi “*Shpalljen e një vendi vakant për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës*”.

Ftohen për paraqitjen e kandidaturave për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, individët që:

- a) janë shtetas shqiptar;
- b) kanë jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale si jurist;
- c) në kohën e kandidimit, të jenë pedagogë me kohë të plotë jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të një institucioni të arsimit të lartë (IAL) ose pedagogë të brendshëm ose të jashtëm jomagjistratë në Shkollën e Magjistraturës;
- d) janë personel akademik të kategorisë “profesor” ose “lektor”;
- e) në kohën e kandidimit të mos jenë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;
- f) nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
- g) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- h) nuk kanë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- i) nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- j) nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve inteligjente;
- k) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të nenit 134 dhe 137 të ligjit nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Propozimi i çdo kandidature duhet të përmbajë:

1. jetëshkrimin e përditësuar të nënshkruar në çdo faqe nga kandidati;
2. librezë pune që provon përmbushjen e kriterit ligjor të përvojës në punë prej jo më pak se 15 vitesh përvojë profesionale si jurist si dhe vërtetimin që në kohën e kandidimit, të jenë pedagogë me kohë të plotë jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të një institucioni të arsimit të lartë (IAL) ose pedagogë të brendshëm ose të jashtëm jomagjistratë në Shkollën e Magjistraturës;
3. vërtetim që është personel akademik i kategorisë “profesor” ose “lektor”;
4. vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
5. deklaratë e Konfliktit të Interesit që gjendet bashkëlidhur këtij njoftimi;
6. vërtetim i gjendjes gjyqësore;
7. një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

8. formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë si dhe bashkëlidhur këtij njoftimi;
9. formularin e plotësuar në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i cili gjendet bashkëlidhur këtij njoftimi;
10. çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 134 të këtij ligji.

Institucionet e arsimit të lartë që kanë në përbërje të tyre si njësi kryesore fakultete të drejtësisë, të akredituara sipas rregullave të legjislacionit në fuqi, si dhe Shkolla e Magjistraturës, të fillojnë procedurat për shpalljen e thirrjeve të interesit, për depozitimin e kandidaturave dhe të dokumentacionit përkatës, si dhe për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të kandidatëve, sipas parashikimeve të neneve 134, 135, 137, 140 e në vazhdim, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATË: __ / __ / ____

I. TË DHËNAT PERSONALE

A. Gjeneralitetet aktuale:

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	
VENDBANIM	
NR. ID	

B. Gjeneralitete të mëparshme:

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

(emër, mbiemër, nënshkrim)

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	

II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a _____ kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

- Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.
- Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.
- Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.
- Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.
- Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

KUJDES: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTJUI SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!

(emër, mbiemër, nënshkrim)

(emër, mbiemër, nënshkrim)

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjë herë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji

2. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë ?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar	Gjykata	Vepra penale për të cilën jeni dënuar		Vendimi përfundimtar/Dënimi
		Neni	Lloji	

3. A keni qenë ndonjë herë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

4. A keni qenë ndonjëherë i ndaluara po arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emer, mbiemer, nënshkrim)

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

5. A është caktuar ndaj jush ndonjë herë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË	PËRGJIGJE	
	Aktualisht në fuqi	E revokuar
Ndalimi i daljes jashtë shtetit		
Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore		
Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar		
Garancia pasurore		
Arresti në shtëpi		
Arresti në burg		
Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik		

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Gjykata	Qyteti, shteti	Vepra penale për të cilën akuzoheshit		Vendimi përfundimtar	Periodha, data
		Neni	Lloji		

6. A është lëshuar ndonjë herë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Autoriteti urdhërues	Arsyeja	Qyteti, Shteti	Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo)

7. A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj? (Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj)

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja dëbimit	Periudha e dëbimit nga shteti i huaj	Të dhenat e aktit të dëblimit

8. A keni jetuar ndonjë herë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja	Periudha	Adresa e vendqendrimit

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Shënim: Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjitini një kopje të tyre këtij Formulari.

Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, shto aq pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

(emër, mbiemër, nënshkrim)

FORMULAR APLIKIMI

PËR INFORMIM PËR ZYRTARËT PËRPARA EMËRIMIT/ZGJEDHJES NË POSTE TË LARTA

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT (AIDSSH)



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: E-mail: info@autoritetidosjeve.gov.al Web: www.autoritetidosjeve.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR PUNONJËSIT E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
Shënim :Julutemplotësonimekujdesdheqart ë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME GËRMA KAPITALE DHE NË NGJYRË BLU.	Nr. i kërkesës

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri 	2. Mbiemri 																				
3. Emra të tjerë <small>Nëse ka</small>	1. 2. 3. 																				
4. Mbiemra të tjerë <small>(para 2 korrikut 1991) Nëse ka</small>	1. 2. 3. 																				
5. NID <small>Nr. i identifikimit personal</small>	6. Gjinia <input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër																				
7. Emri i Babait 	8. Mbiemri i babait 																				
9. Emri i nënës 	10. Mbiemri i nënës <small>Përpara martesë</small> 																				
11. Datëlindja <table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"><tr><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td><td style="border: 1px solid black; width: 20px; height: 20px;"></td></tr><tr><td style="text-align: center; font-size: 8px;">Data</td><td style="text-align: center; font-size: 8px;">Muaji</td><td style="text-align: center; font-size: 8px;">Viti</td><td colspan="7"></td></tr></table>											Data	Muaji	Viti								12. Vendlindja
Data	Muaji	Viti																			
13. Shtetësia 	14. Shtetësi të tjera <small>Nëse ka</small> 																				
15. Adresa 																					
16. Qyteti 	17. Rrethi 																				
18. Kodi Postar 	19. E-mail 																				
20. Nr. Tel. Celular 	21. Nr. Tel. Fiks 																				

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

22. Funkzioni aktual	
23. Funkzioni për të cilin kandidon	
24. Subjekti në të cilin kandidon	
25. Arsyeja e kandidimit	<input type="checkbox"/> Përpara emërimit <input type="checkbox"/> Ngritje në detyrë <input type="checkbox"/> I zgjedhur

SEKSIONI C: INFORMACION SHITESHE PER TE DHENA NDIHMESE PER IDENTIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT

ARKIVOR

1. VENDI I BANIMIT/PUNES PAS MBUSHJES SE MOSHES 18 VJEC (PARA 2 KORRIKUT 1991)

Nr.	Qyteti	Vendi i Punës

2. A KENI APLIKUAR MË PARË PËR VERIFIKIM FIGURE?

Komisioni Mezini

Komisioni Bezhani

Kopje dokumenti nëse ka

SEKSIONI D: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Fotokopje e kartës së identitetit.

Kopje e notuar e vendimit të ndryshimit të emrit, nëse ka emra apo mbiemra të tjerë (plotësuar sipas pikës 3 dhe 4).

Argumentimi nga Subjekti për trajtimin e kërkesës me përparësi.

Shënim: Ky formular plotësohet dhe nënshkruhet nga aplikanti, dhe institucioni kërkues e dërgon pranë Autoritetit.

Nënshkrimi i Aplikantit

--	--	--	--	--	--	--	--

Data

Muaji

Viti

Formular Deklarimi

Deklaruesi:

Kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës:

Unë i nënshkruari, _____, nën përgjegjësinë time të plotë ligjore dhe morale, lëshoj këtë deklaratë në cilësinë e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga pika 3 e nenit 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar:

- Se nuk kam mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- Në kohën e kandidimit, nuk kam asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.
- Nuk jam bashkëpunëtor/informator/agjent i shërbimeve inteligjente

dhe se në çdo rast do të shmang pozitat e papajtueshmërisë dhe papërshtatshmërisë së ushtrimit të funksionit sipas përcaktimeve të nenit 149/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Deklaruesi

Tiranë më _____

Emër Mbiemër

Firma

Formular Deklarimi

Deklaruesi:

Kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës:

Unë i nënshkruari, _____, nën përgjegjësinë time të plotë ligjore dhe morale, lëshoj këtë deklaratë në cilësinë e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga pika 3 e nenit 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar:

- Se nuk kam mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- Në kohën e kandidimit, nuk kam asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.
- Nuk jam bashkëpunëtor/informator/agjent i shërbimeve inteligjente

dhe se në çdo rast do të shmang pozitat e papajtueshmërisë dhe papërshtatshmërisë së ushtrimit të funksionit sipas përcaktimeve të nenit 149/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Deklaruesi

Tiranë më _____

Emër Mbiemër

Firma

